



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 527/3 prot.

Tiranë, më 26. 05. 2020

V E N D I M

Nr. 53, Datë 26. 05. 2020

Mbështetur në ligjin Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa Nr. 29, datë 27.04.2020, e shtetasve P. M. dhe S. B., në cilësinë¹ e përfaqësuesve të Sindikatës së Minatorëve/Gjeologëve të Punës Nëntokë, Dega Pukë, kundër Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilën pretendohet diskriminim *pa përcaktuar një shkak*.

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Ankuesit kanë sqaruar se, pas mbylljes së punës dhe aktivitetit të Gjeologji Minerave, në vitin 2000 dhe si rezultat i papunësisë së krijuar, qeveria e asaj kohe miratoi ligjin nr. 8685, datë 09.11.2000 “*Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë*” dhe në zbatim të tij, miratoi Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 73, datë 15.02.2001 “*Për kriteret dhe masën e trajtimit të veçantë të punonjësve që kanë punuar në minierë, nëntokë*”. Sipas këtyre parashikimeve ligjore punonjësit e papunë të nëntokës përfitonin një trajtim të veçantë prej 5148 lekë dhe një pjesë e tyre me shumën 6500 lekë. Duke qënë se kjo shumë nuk i mbulonte nevojat jetike të kësaj kategorie, një pjesë e tyre pavarësisht trajtimit të veçantë, kanë vijuar të punojnë në punë të tjera duke përfituar njëkohësisht edhe pagesën e si ish punonjës të minierave.

¹ Pavarësisht se e kanë pretenduar, nuk kanë paraqitur asnjë dokument për të vërtetuar faktin se ankuesit janë përfaqësues të Sindikatës së Minatorëve/Gjeologëve të Punës Nëntokë, Dega Pukë.

Pavarësisht ndryshimeve të pësuara në vitin 2005 dhe në vitin 2007, ligji nr. 8685, datë 09.11.2000 *“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”*, parashikonte se: *“Personi, që ka përfituar të ardhura, në mënyrë e me mjete të padrejta, si dhe që nuk njofton ndryshimin ose heqjen e masës së tyre, detyrohet të kthejë të gjithë shumën e marrë tepër. Masa e ndalesës për çdo muaj është 50 për qind e këstit mujor të trajtimit të veçantë.”*

Sipas ankuesve, duke qënë se kategoria e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, nuk kanë patur dijani mbi parashikimin e sipërcituar, kanë krijuar detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, pasi nuk kanë deklaruar punësimin e tyre dhe nuk kanë kërkuar heqjen e trajtimit të veçantë për periudhën që kanë qënë të punësuar.

Me miratimin e ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*, i cili parashikonte uljen e moshës së daljes në pension pleqërie në 55 vjeç, një pjesë e kësaj kategorie përfituan pension pleqërie, por vazhduan edhe të punojnë, duke krijuar kështu detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

Me miratimin e ligjit nr. 72/2017 *“Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”*, kategoria e personave të cilët kanë përfituar pension pleqërie sipas ligjit nr. 150/2014 dhe njëkohësisht kanë punuar, u janë falur të gjithë detyrimet ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore deri më datë 31.12.2016.

Përsa më sipër, ankuesit pretendojnë se kategoria e personave që janë trajtuar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 *“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”*, janë vënë në kushte të pabarabarta dhe diskriminuese në raport me personat që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*, pasi vetëm për këtë kategori janë falur detyrimet e akumuluar ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore.

Në përfundim, ankuesit kanë kërkuar nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të marrë masat që edhe personat që janë trajtuar sipas ligjit nr. 8685, datë 09.11.2000 *“Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”* dhe kanë detyrime ndaj Fondit të Sigurimeve Shoqërore, tu falen këto detyrime dhe të trajtohen si kategoria e personave që kanë përfituar pension sipas ligjit nr. 150/2014 *“Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera nëntokë”*.

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e sjellë pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna prej subjekteve ankues, përfaqësimin e tyre, shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore me trajtimin më pak të favorshëm.

- Për këtë arsye, me anë të komunikimit telefonik më datë 27.04.2020 dhe 04.05.2020, Komisioneri i kërkoi ankuesve² të paraqesin shpjegime lidhur me shkakun e pretenduar (nuk kishin përcaktuar një shkak), trajtimin e pabarabartë dhe depozimin e një dokumenti për t'u legjitimuar përpara Komisionerit (nuk kishin depozituar asnjë akt si përfaqësues të Sindikatës së Minatorëve/Gjeologëve të Punës Nëntokë, Dega Pukë). Nga ana e tyre nuk u arrit të identifikohet shkakun e diskriminimit, si dhe nuk ishte e mundur vënia në dispozicion e akteve të kërkuara pranë Komisionerit.

Në përfundim të arsyetimit dhe informacionit të sipërcituar ankuesit, nuk vënë në dispozicion të KMD-së asnjë argument apo provë lidhur me shkakun e pretenduar të diskriminimit dhe përfaqësimit të tyre.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.*

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Gjithashtu, diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstron viktimën e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili

² Shtetasit P. M.

nuk posedon karakteristikën e mbrojtur. Ankuesit në rastin në fjalë nuk kanë paraqitur asnjë dokument apo provë, lidhur me shkakun e diskriminimit.

Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë jo shteruese shkaqesh. Në rastin konkret, ankuesit duhet të identifikonin një cilësi apo karakteristikë të kategorisë së personave për të cilën pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme.

Nga ana e ankuesve është paraqitur informacion mbi trajtimin e diferencuar në raport me kategorinë e personave të cilët kanë përfituar nga falja e detyrimeve sipas ligjit nr. 72/2017, por nuk ka paraqitur fakte dhe prova apo shpjegime për të provuar shkakun e diskriminimit dhe për të provuar se trajtimi i pabarabartë i tij është bërë për shkak të cilësive të veçanta që kjo kategori personash ka.

Gjithashtu, në nenin 33, pika 1 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, parashikohet se: *“Një person ose grup personash që pretendojnë se janë diskriminuar, ose një organizatë me interesa legjitime që pretendon diskriminim në emër të një personi apo grupi personash, mund të paraqesë ankesë së bashku me provat e disponueshme para komisionerit, me shkrim ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahet procesverbal”*. Në këtë kuptim, ankuesit duhet të kishin vënë në dispozicion të Komisionerit një dokument përfaqësimi të grupit të personave që pretendojnë se janë diskriminuar ose, në raste përjashtimore, gojarisht, në mënyrë që të mund të mbahej procesverbal.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se *“Ankesa nuk pranohet nëse është haptazi e pabazuar ose nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim”*, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/a, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 4/ç dhe 10 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së shtetasve P. M. dhe S. B., për shkak se nuk ka informacion të mjaftueshëm për të bërë të mundur një hetim.

2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Pa shkak)

(Fusha: Të mira dhe shërbime)